

## RELACION

### PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR SHPALLJEN “PARK NATYROR BASHKIAK” (PNB), TË ZONËS “KOLLOGJESH-MALI I FAGUT””

Drejtoria e Përgjithshme e Integritit, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Ekonomik në cilësinë e strukturës përgjegjëse që planifikon dhe menaxhon çështje që lidhen me promovimin e vlerave të territorit me qëllim nxitjen e investitorëve, vendas apo të huaj, paraqet relacionin si më poshtë:

Referuar parashikimeve të vendimit nr. 636/2019, të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Kriteve dhe të Procedurave të Shpalljes dhe Administrimit të Parqeve Natyrore Bashkiake”, parashikohet shprehimisht se parku natyror bashkiak, krijohet në nivel bashkie duke respektuar procedurën e parashikuar në këtë vendim.

Nisur nga sa më sipër, theksojmë se sipërfaqja objekt i këtij projektvendimi perfshihet në VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/ bashkive”, i ndryshuar, me një sipërfaqe prej 2015.62 ha, dhe ndodhet brenda territorit të Bashkisë Tiranë, dhe është në pronësi të saj dhe aktualisht në proces regjistrimi pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Në kuadrin e masave të propozuara në dokumentin e politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit dhe habitateve në Shqipëri për zgjerimin e sistemit të zonave të mbrojtura, propozon që një pjesë të ekonomisë pyjore Fag, territori i zones “**Kollagjesh-Mali i Fagut**” në pronësi të Bashkisë Tiranë, të miratohet propozimi për shpalljen Park Natyror Bashkiak, pasi plotëson kriteret VKM-së 636/2019, “Për Miratimin e Kriteve dhe të Procedurave të Shpalljes dhe Administrimit të Parqeve Natyrore Bashkiake”.

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga vendimi sipërcituar është mbajtur korrespondencë me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, e cila pasi ka shqyrtuar kërkesën e drejtorisë sonë, relacionin dhe dokumentat bashkëlidhur, me anë të shkresës nr. 2435/1, datë 14.09.2023, ka bërë me dije se sipërfaqja e parcelave të propozuara për tu shpallur park natyror bashkiak plotëson kriteret për tu shpallur (PNB), referuar kriteve të përcaktuara shprehimisht në VKM-në 636/2019, pasi është zonë tërësisht natyrore, e rigjeneruar, që shërben për plotësimin e nevojave të komunitetit për veprimtari ekonomike, sociale dhe tradicionale. Kjo zonë është e pasur me vlera nga pikëpamja floristike dhe faunistike dhe nuk ka habitate me lloje të rrezikuara, të kërcënuara, si specie të rralla dhe endemike të cilat mbrohë në nivel kombëtar e rajonal me një akt të veçantë normativ. Kjo zonë dallohet për larmi të llojeve bimore deri te bimët shumëvjeçare dhe pyje të lartë ku zotëron Ahu dhe Dushqet. Gjithashtu, zona është e pasur edhe me bimë mjekësore, përkatësisht kërpudha të llojeve të ndryshme si dhe me llojshmëri të faunës së egër, duke i dhënë vlera të mëdha të biodiversitetit.

Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Integritit, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Ekonomik, (Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Rural), duke mbajtur në konsideratë vendimin e lartpërmendur si

edhe në kuadrin e masave të propozuara në dokumentin e politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit dhe habitateve në Shqipëri për zgjerimin e sistemit të zonave të mbrojtura, kreu studimin e zonës së propozuar në terren dhe konkudoi gjithashtu se sipërfaqja e propozuar i plotëson të gjitha kriteret për tu shpallur “Park natyror Bashkiak”, përkatësisht si më poshtë vijon:

- Janë kryesisht zona natyrore, të ripyllëzuara, që shërbejnë për plotësimin e nevojave të komunitetit për veprimtari ekonomike, sociale dhe tradicionale.
- Janë të populluara me lloje të florës dhe faunës, kryesisht të karakterit lokal.
- Nuk janë habitate të llojeve të rrezikuara, të kërcënuara, të rralla dhe endemike, të cilat mbrohen në nivel kombëtar e rajonal me një akt të veçantë normativ.
- Sipërfaqet e propozuara nuk janë përfshirë në rrjetin ekzistues Kombëtar të Zonave të Mbrojtura apo që janë parashikuar për t'u përfshirë, në zbatim të dokumentave strategjikë të ruajtjes së biodiversitetit apo edhe programeve kombëtare.

Ky propozim përcakton gjithashtu:

- ✓ Qëllimin që synohet të shpallet “Park Natyror Bashkiak”,
- ✓ Objektivat e menaxhimit të tij.
- ✓ Vendndodhjen,
- ✓ Kufijtë orientues

### **Qëllimi.**

Qëllimi i marrjes së kësaj nisme, është të japë orientimet strategjike të nevojshme përmes një vlerësimi të burimeve natyrore dhe potencialeve të tyre për zhvillimin ekonomik-social të zonës, për plotësimin e programeve dhe aktiviteteve që marrin parasysh përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore ekzistuese, të pyjeve, kullotave, florës dhe faunës, veprimtarive turistike, bimëve mjekësore dhe vlera të tjera natyrore dhe të japë rekomandimet për zhvillimin, përdorimin dhe shfrytëzimin e resurseve të kësaj zone.

### **Objektivat kryesorë të menaxhimit të PNB “Kollagjesh-Mali i Fagut”, do të jenë:**

- ✓ Evidentimi i vlerave natyrore, kulturore, historike, shoqërore, rekreative, turistike të zonës.
- ✓ Promovimi i këtyre vlerave në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.
- ✓ Ndërthurja e këtyre vlerave dhe ofrimi i një pakete të integruar turistike.
- ✓ Zhvillimi i qëndrueshëm i zonës si elementi jetësor bazë që garanton evidentimin, ruajtjen dhe zhvillimin e të gjitha vlerave aktuale që ka zona.

### **Vendodhja.**

Zona “**Kollagjesh-Mali i Fagut**”, për të cilën kërkohet miratimi i propozimit për shpalljen park natyror bashkiak, bën pjesë në territorin e Bashkisë Tiranë, në lindje të qytetit të Tiranës në një distance 55 km, ndodhet në Njësinë Administrative Shëngjergj, në jug-lindje të saj në një largësi prej 15 km nga qendra e saj. Është territor i ekonomisë pyjore Fag, miratuar me VKB nr.168, datë 18.12.2020 dhe nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën Nr. 742/1, datë 26.03.2021, Për miratimin e planit të mbarshimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore Fag.

Si pjesë e ekonomisë pyjore Fag, zona që propozohet ka një sipërfaqe të përgjithshme 2015.62 ha, shtrihet në zonën klimatike mesdhetare malore me stinën e verës të freskët dhe dimër të ftohtë me reshje dëbore dhe ngrica të herë pas hershme. Ndodhet në një lartësi mesatare prej 1,200 m mbi

nivelin e detit, me lartësi minimale mbi nivelin e detit 900 m dhe lartësi maksimale 1,444 m, e cila është dhe maja më e lartë, mali i Fagut.

Natyrë, bukuritë natyrore dhe peisazhet e shumta me vlera të spikatura, relievet malore, biodiversiteti, prania e dy ujë mbledhësve, burimet ujore natyrore, klima e përshtatshme për shëndetin e njeriut që zona ka, e kombinuar kjo edhe me florën dhe faunën shumë të pasur si dhe me afërsinë me qytetin e Tiranës, e bëjnë këtë zonë me perspektiva të jashtëzakonshme për zhvillimin e turizmit, për qëllime pushimi dhe argëtimi e aksesueshme gjatë gjithë periudhës së vitit.

Prodhimi bujqësor dhe blegtoral i fshatrave përreth zonës mund të konsiderohet i gjithi në funksion të zhvillimit të turizmit në zonë duke siguruar një cikël të sigurtë për punësimin dhe rritjen e mirëqenies së popullatës lokale.

Në studimin për shpalljen e Parku Natyror Bashkiak “Kollogjesh-Mali i Fagut”, janë përfshirë parcelat 5, 6, 17, 30, 38, në vazhdim me parcelat 78 – 94, 96 – 106, duke përfunduar me parcelat 126 – 139.

Në pasqyrën e mëposhtme paraqitet gjendja aktuale e pyjeve dhe kullotave të zonës të marrë në studim, mbi sipërfaqen, volumin drusor në m<sup>3</sup> si dhe llojet kryesore:

**Gjendja aktuale e pyjeve dhe kullotave, paraqitet si vijon:**

| Nr.           | Emërtimi                             | Lloji Pyjor       | TOTALI            |                          |                   |                  |
|---------------|--------------------------------------|-------------------|-------------------|--------------------------|-------------------|------------------|
|               |                                      |                   | Sipërfaqja (Ha)   | VOLUMI (m <sup>3</sup> ) |                   |                  |
|               |                                      |                   | Gjithsej          | Lëndë                    | Punimi            | Dru zjarri       |
| <b>I</b>      | <b>Pyje Gjithsej (1 + 2 + 3)</b>     |                   | <b>1,635.20</b>   | <b>256,445.00</b>        | <b>203,347.00</b> | <b>53,098.00</b> |
|               | <b>Trungishte (Halore + Fletore)</b> |                   | <b>1,540.53</b>   | <b>254,189.00</b>        | <b>203,012.00</b> | <b>51,177.00</b> |
| <b>1</b>      | Halore                               | Pish e zezë       | 25.75             | 2,304.00                 | 1,343.00          | 961.00           |
|               |                                      | <b>Totali</b>     | <b>25.75</b>      | <b>2,304.00</b>          | <b>1,343.00</b>   | <b>961.00</b>    |
|               | Fletore                              | Ah                | 1,101.91          | 213,577.00               | 174,866.00        | 38,711.00        |
|               |                                      | Panjëmali         | 11.31             | 870.00                   | 761.00            | 109.00           |
|               |                                      | Gështenjë         | 6.26              | 1,123.00                 | 948.00            | 175.00           |
|               |                                      | Qarr              | 395.30            | 36,315.00                | 25,094.00         | 11,221.00        |
| <b>Totali</b> | <b>1,514.78</b>                      | <b>251,885.00</b> | <b>201,669.00</b> | <b>50,216.00</b>         |                   |                  |
| <b>2</b>      | <b>Cungishte</b>                     | Qarr              | 16.6              | 1,679.00                 | 335.00            | 1,345.00         |
|               | <b>Totali</b>                        |                   | <b>16.60</b>      | <b>1,680.00</b>          | <b>335.00</b>     | <b>1,345.00</b>  |
| <b>3</b>      | <b>Shkurre</b>                       | Shkozë e zezë     | 34.86             | 274.00                   | 0.00              | 274.00           |
|               |                                      | Shkurret tjera    | 43.21             | 302.00                   | 0.00              | 302.00           |
|               | <b>Totali</b>                        |                   | <b>78.07</b>      | <b>576.00</b>            | <b>0.00</b>       | <b>576.00</b>    |
| <b>II</b>     | <b>Kullota</b>                       |                   | <b>231.50</b>     |                          |                   |                  |
| <b>III</b>    | <b>Sipërfaqe me bimësi Pyjore</b>    |                   | <b>21.08</b>      |                          |                   |                  |
| <b>IV</b>     | <b>Djerr</b>                         |                   | <b>31.73</b>      |                          |                   |                  |
| <b>V</b>      | <b>Joproductive (shkëmbore)</b>      |                   | <b>38.80</b>      |                          |                   |                  |

|            |                    |                 |                   |                   |                  |
|------------|--------------------|-----------------|-------------------|-------------------|------------------|
| <b>VI</b>  | <b>Ujore</b>       | <b>10.50</b>    |                   |                   |                  |
|            | <b>FONDI PYJOR</b> | <b>1,968.81</b> | <b>256,445.00</b> | <b>203,347.00</b> | <b>53,098.00</b> |
| <b>VII</b> | <b>Bujqësore</b>   | <b>46.81</b>    |                   |                   |                  |
|            | <b>TOTALI</b>      | <b>2,015.62</b> |                   |                   |                  |

Sa vërehet nga tabela e mësipërme, zona dominohet nga pyjet të cilët zënë **1635.20 ha ose 81.13 %**, të sipërfaqes totale, e ndarë në trugishte të cilat zënë një sipërfaqe prej 1540.53 ha ose 76.43 %, kundër llojet dominues është Ahu (*Fagus sylvatica*) me sipërfaqe prej 1101.91 ha ose 54.67 % të sipërfaqes së mbualuar me pyje, Qarrin (*Cucucus cerris*) zë një sipërfaqe prej 395.30 ha ose 19.61 %, pisha e zezë +panja e malit+gështenja zënë një sipërfaqe prej 43.32 ha ose 2.15%, kurse sipërfaqja prej 94.67 ha ose 4.70 % është e pasur me llojet e tjera të bimësisë si shkoza e zezë, lisi etj. Pjesa tjetër e totalit të **sipërfaqes prej 380.42 ha ose 18.87 %** është e mbuluar me (kullota, sipërfaqe me bimësi pyjore, djerr, joproductive (shkëmbore) dhe tokë bujqësore.

Zona përveç shumëllojshmërisë të bimësisë të llojeve pyjore, është edhe mjaft e pasur dhe me resurse të tjera, ku një vend të rëndësishëm zënë edhe prodhimet e dyta dhe si të tilla mund të përmendim trandafilin e egër, trumzën, luleshtrydhen, kërpudhat, dëllinjën e kuqe dhe të zezë etj, kungashfrytëzimi tyre banorët vendassigurojnë të ardhurat të konsiderueshme.

Shumëllojshmëria e kafshëve dhe e shpendëve përbën një tjetër vlerë të shtuar, ku si lloje më kryesore mund të përmendim Ariun (*Ursus arctos*), Derrin e egër (*Sus scrofa*), Ujkun (*Canis lupus*), Dhelprën (*Canis vulpes*), Lepurin (*Lepus Europaeus*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), etj.

Nga shpendët përmendim, pëllumbin e egër, thëllënzën, shqiponjën, qukapikun, qyqen, mëllenjën, etj.

Zona është e pasur edhe me peshk në dy rezervuarët që ndodhen në Kollagjesh, të cilët kanë sasi të konsiderueshme peshku të kultivuar, kryesisht ballgjeri.

### **Kufijtë orietues të zonës:**

#### **Veriu:**

Kufizohet me ekonominë pyjore Vërri, fillon me kurrizin e Perregtosit, ngjitet në majën e Batrës, në majën e malit të Fagut (1,444 m), zbret në qafën e Shëngjinit në kuotën 1,187 m, Kalgjergj, vazhdon në rrugën auto që lidhet me Bizën, deri në Qaf-Shpellëz.

Në konturin e jashtëm verior, zona kufizohet nga zona e mbrojtur e ekonomisë pyjore Vërri të cilat janë pjesë e zgjerimit të Peisazhit të Mbrojtur “Mali me Gropa-Bizë-Martanesh” dhe të Parkut Kombëtar “Mali I Dajtit”.

#### **Jugu:**

Kufizohet me ekonominë pyjore Korrë me kufi të qartë natyral. Kurrizi që ngjitet në kuotën 1,410 m, vazhdon përgjatë gjithë kurrizit sipas vijës ujëndarëse, respektivisht në kuotat, 1,395 m, 1,380 m, vazhdon përgjatë kurrizit duke u ulur në kuotat 1,350 m dhe përfundon përgjatë kurrizit në kuotën 1,200 m.

#### **Lindje:**

Kufizon me kufirin ndarës me bashkinë Elbasan, icily fillon nga qafa Shpellëz duke vijuar kurrizet deri në kuotën 1,254 m.

**Perëndimi:**

Parcela nr. 5, Batër, përgjatë rrugës këmbësore horizontalisht në drejtim jugor në Kronaz fundi i shpatit të malit Kryshpat, vazhdon horizontalisht përgjatë rrugës këmbësore Shkëmbi Kuq, faqja e Brukës-Kodër Gjocit (kuota 1,050 m), ulet përgjatë kurrizit deri te fillimi i livadhit, zbret përgjatë shpatit sipas një këndi të drejtë në degëzimin e përroit, vazhdon ulet përgjatë përroit deri në përroin kryesor të fshatit Vakumonë, ngjitet përgjatë përroit deri në kryqëzimin e dy përrejtjeve, vazhdon ngjitjen përgjatë kurrizit në kuotën 1,140 m (Sheshes), ulet kurrizit në përroin e lagjes Vakumonë e sipërme, ngjitet në degëzimin tjetër të përroit deri në kufirin e sipërm të tokave të bukës, vazhdon horizontalisht përgjatë fundit të shpatit të pjerrët deri në kurriz mbi sipërfaqen e zhveshur kufirin e fshatit Korrë të rrethit të Elbasanit.

Gjithashtu, në funksion të këtij procesi, i jemi drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, me anë të shkresës nr. 15446 datë 18.04.2023, kërkesë për informacion në kuadër të zhvillimit të planit vendor të Bashkisë Tiranë, përkatësisht nëse ka një plan zhvillimi për këtë teritor me shkresën. Në kthim përgjigjen me nr. 15446/3, datë 18.07.2023, nga DPPZHT, na bëhet me dije se sipërfaqja e kërkuar ndodhet në teritorin e Bashkisë Tiranë, dhe nuk ka një plan zhvillimi që pengon shpalljen e këtij teritori Park Natyral Bashkiak.

Në vijim, në zbatim të kërkesave të VKM-së nr. 636, datë 25.09.2019 “Për miratimin e kritereve dhe të procedurave të shpalljes dhe administrimit të parqeve natyrore bashkiake, kreu III pika 4 gërma d, në të cilën përcaktohet gjithashtu se propozimi publikohet për një afat dy mujor, në këndin e njoftimeve të njësisë administrative ku përfshihet sipërfaqja e PNB-së së propozuar, ku komuniteti dhe bizneset e zonës japin mendim. Në përmbushje të këtij detyrimi me anë të shkresës nr. 33909 prot, datë 02.10.2023, i jemi drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë, me qëllim afishimin e njoftimit. Më anë të shkresës nr. 33909/1 prot, datë 11.10.2023, është kthyer përgjigje se është kryer afishimi në stendat e lajmërimeve për publikun të njoftimit në fjalë, pranë Bashkisë Tiranë. Në përfundim të afatit dy mujor nuk jemi njoftuar për mendime, sugjerime në lidhje me propozimin e bërë nga banoër apo bizneset e zonës. Gjithashtu, me anë të shkresës nr. 13605 prot., datë 03.04.2023, i jemi drejtuar Njësisë Administrative Shëngjergj, me anë të së cilës kemi kërkuar mendim/sugjerim në lidhje me miratimin e propozimit për shpalljen park natyror bashkiak të zonës “Kollogjesh-Mali i Fagut”, identifikuar në hartën bashkëlidhur projektvendimit. Njësia Administrative Shëngjergj me anë të shkresës 342/1 prot., datë 26.07.2023, në konsultim edhe me Kryetarët e Fshatrave, ka shprehur dakordësinë/pëlqimin për miratimin e propozimit për shpalljen PNB, të zonës së lartpërmendur.

Në këto kushte, Drejtoria e Përgjithshme e Integritit, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Ekonomik, në cilësinë e strukturës përgjegjëse për administrimin e çështjeve që lidhen me hartimin e politikave dhe planeve për mbrojtjen, zhvillimin, shfrytëzimin e kontrolluar të fondit pyjor e kullësor pjesë e territorit të Bashkisë Tiranë, me qëllim arritjen e objektivave të saj strategjike dhe përmbushjen e rezultateve të kërkuara nga kjo njësi organizative, duke mbajtur në konsideratë plotësimin e kushteve/kritereve të kërkuara nga vendimi nr. 636 datë 25.09.2019 “Për miratimin e kritereve dhe të procedurave të shpalljes dhe administrimit të Parqeve Natyror Bashkiakë”, propozojmë pranë Këshillit Bashkiak, në cilësinë e organit vendimarrës, miratimin e projektvendimit “Për miratimin e propozimit për shpalljen “Park Natyror Bashkiak” (PNB), të zonës “Kollogjesh-Mali i Fagut”.

**FOTO ILUSTRUESE TË ZONËS**











REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKT VENDIM**  
Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, 2023

**“PËR  
MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR SHPALLJEN “PARK NATYROR BASHKIAK”, (PNB)  
TË ZONËS “KOLLOGJESH-MALI I FAGUT””**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “a” dhe “b”, nenit 27 pika 5, nenit 54 shkronjat “k”, nenit 55 pikat 2 dhe 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, të pikës 1 dhe 2 të nenit 5, të ligjit Nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar, të nenit 1, nenit 8, nenit 14 dhe nenit 19 të ligjit Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura, të shkronjës “dh” dhe “e” të pikës 4, dhe të pikës 6, të kreut III, të vendimit Nr. 636 datë 25.09.2019 “Për miratimin e kritereve dhe të procedurave të shpalljes dhe administrimit të parqeve natyrore bashkiakë”, vendimit nr. 433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të Ish-komunave/bashkive”, i ndryshuar, si dhe në vijim të memos nr. 42221 prot., datë 30.11.2022, të Drejtorisë së Përgjithshme të Integritit, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Ekonomik, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e propozimit për shpalljen “Park Natyror Bashkiak” (PNB), të zonës “Kollogjesh-Mali i Fagut”, sipas hartës në aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Integritit, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Ekonomik, të marrë të gjitha masat e nevojshme për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në vendimin nr. 636 datë 25.09.2019, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kritereve dhe të procedurave të shpalljes dhe administrimit të parqeve natyrore bashkiake”, në funksion të shpalljes Park Natyror Bashkiak të zonës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Integritit, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Ekonomik për ndjekjen e dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**K R Y E T A R I**

**ROMINA KUKO**